

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) Rruga "MIGJENI" (ish-Banka e Ljublanës) Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel:+ 383 38 212 309 e-mail: oshp@rks-gov.net

PSH.nr 410/22

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje prej Kimete Gashi - Kryetare, Agon Ramadani – Anëtar, Vedat Poterqoi – Anëtar duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: “Avokatra Istrefi”, kundër njoftimit për anulim për aktivitetin e prokurimit: “Shërbimet e veçanta kontraktuese për përfaqësim ligjor për nevojat e Komunës së Prishtinës”, me nr. të prokurimit: 616-21-3575-2-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) - KK Prishtinë, më datën: 12.12.2022, mori këtë:

VENDIM

I.APROVOHET si e bazuar ankesa e OE ankues “Avokatura Istrefi”, kundër njoftimit për anulim për aktivitetin e prokurimit: “Shërbimet e veçanta kontraktuese për përfaqësim ligjor për nevojat e Komunës së Prishtinës”, me nr. të prokurimit: 616-21-3575-2-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) - KK Prishtinë.

II.OBLIGOHET Autoriteti Kontraktues që, nëse për këtë lloj aktiviteti ka të parapara mjete për vitin 2023 lëndën ta kthej në rivlerësim dhe të vazhdoj me këtë aktivitet të prokurimit saktësisht me nr. 616-21-3575-2-1-1 deri në nënshkrimin e kontratës.

III. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informoj OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën për mos respektim të vendimit, OSHP mund të ndërmarr masa ndaj AK sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131, të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës (versioni i konsoliduar).

IV. Me qenë se ankesa e për OE ankues “ Avokatura Istrefi ”, aprovet si e bazuar, lejohet kthimi i shumës së deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës për OE konform nenit 31 pika

6 të Rregullores të Punës së OSHP, kurse OE i cituar ka të drejtë që në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjnë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën konfiskohet depozitës dhe mjetet kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës;

Arsyetim

Operatori ekonomik ankues “Avokatura Istrefi” si palë e pa kënaqur me datën 28.08.2022 ka parashtruar ankesë në OSHP, ankesë kjo e protokolluar nga OSHP me numër 410/2022, kundër njoftimit për anulim për aktivitetin e prokurimit: “Shërbimet e veçanta kontraktuese për përfaqësim ligjor për nevojat e Komunës së Prishtinës”, me nr. të prokurimit: 616-21-3575-2-1-1, aktivitet ky i prokurimit i iniciuar dhe i zhvilluar nga autoriteti kontraktues - KK Prishtinë, duke pretenduar që AK ka vepruar në kundërshtim me: nenin 1,6,7,8.9, 22,39, 40, 41, 62 të LPP-së.

Ankesa e OE është ushtruar në pajtim me nenin 109.1, të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK çdo palë e interesuar mund të parashtojë ankesë pranë OSHP. Meqë OE ka ushtruar po ashtu kërkesë për rishqyrtim, do të thotë se veprimet e të njëjtit i referohen po ashtu dhe nenit 108/A të Ligjit të cituar. Prandaj OSHP konsideron se Ankesa i plotëson kushtet e parapara në kuptim të dispozitave tani më të cituara dhe e njëjta bie nën kompetencat e tij në kuptim të nenit 105. të LPP.

OE Ankues në ankesën e tij ka parashtruar pretendimet si në vijim :

Kjo procedurë e prokurimit ka qenë objekt shqyrtimi në OSHP, përkatësisht është nxjerr raport i ekspertizës me nr. 642/21, ne kemi qenë të përzgjedhur për të nënshkruar kontratë, ka pasur ankesë kundër dhënies, përderisa, paneli shqyrtues ankesën e njëjtë përmes vendimit të datës 12.07.2022, e ka hedhë si jashtë afatit për shqyrtim dhe nuk ka dhënë ndonjë obligim ndaj AK-KK Prishtinë.

AK – KK Prishtinë, pas pranimit të vendimit të PSH-se, me datën 19.08.2022, publikon njoftimin për anulim, dhe ka zhvilluar aktivitet tjetër të prokurimit dhe ka nënshkruar kontratë e cila tanimë është aktive, është lidhur me afat 6 mujor dhe skadon më datën 15.01.2023.

Parashtruesi i ankesës përmes kërkesës për ri shqyrtim të datës 28.08.2022, kërkon anulimin e vendimit të AK me pretendimet ankimore të njëjta si në ankesën, ndërsa AK nuk ka bërë shqyrtimin e kërkesës, duke vazhduar kështu më nënshkrimin e kontratës.

Pra kërkesa për ri shqyrtim ishte parashtruar me datën 23.08.2022

Me datën 24.08.2022 publikon njoftimin mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim

Me datën 28.08.2022 është parashtruar ankesa në OSHP.

OSHP ka angazhuar ekspertin shqyrtues të prokurimit, që në pajtim nën 113 të LPP ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore. Eksperti shqyrtues ka dorëzuar raportin e ekspertizës duke i propozuar Panelit Shqyrtues që:

MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE të aprovohet si pjesërisht e bazuar në të njëjtën i mbetet panelit shqyrtues të marrë vendim përfundimtarë për këtë procedurë /aktivitet të prokurimit .

OSHP me datën 06.10.2022, i ka njoftuar AK dhe OE me raportin e ekspertit shqyrtues.

Autoriteti kontraktues ka kthyer përgjigje dhe nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Ndërsa OE ankues pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Bazuar në shkresat e kësaj lënde dhe qëllimin parësor të ankesës, Paneli konsideroi se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të mbahet seanca dëgjimore me palë, përderisa parashtrirat e palëve dhe veprimet e tyre, përbëjnë bazë të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritator. Në këtë rast, Paneli Shqyrtues konstatimet e tij i bazoi kryesisht në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, të cilat mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit, sikurse Ankesa në këtë rast.

Duke marrë për baze faktin se AK –KK Prishtinë, pas pranimit të vendimit të PSH-se, me datën 19.08.2022, publikon njoftimin për anulim dhe se dhe ka zhvilluar aktivitet tjetër të prokurimit dhe ka nënshkruar kontratë e cila tanimë është aktive, është lidhur me afat 6 muaj dhe skadon më datën 15.01.2023

PSH vlerëson se AK ka publikuar njoftimin për anulim të këtij aktiviteti të prokurimit në kundërshtim me nenin 62 të LPP-së me të cilin përcaktohet qartë dhe të cilat decidivisht përcaktojnë kur përfundon një aktivitet i prokurimit.


PSH sipas arsytimit të dhënë nga ana e AK-së lidhur me anulimin e këtij aktiviteti me datë 05.12.2022 ka kërkuar sqarime nga AK. Meqenëse sqarimet nuk kanë qenë të mjaftueshme për PSH si dhe duke qenë se autoriteti kontraktues kontratën e ka të nënshkruar vetëm për 6 muaj obligohet AK nëse për këtë natyrë të aktivitetit të prokurimit kanë mjete të parapara për vitin 2023 të vazhdoj me këtë aktivitet të prokurimit nr. 616-21-3575-2-1-1 deri në nëshkrimin e kontratës.

PSH gjithashtu këtë vendim e bazoj edhe në frymën e konsistencës me rastet e ngjashme për të cilat objekt shqyrtues kanë vendimet e AK-ve dhënie –anulim me arsytimin mbi anulim duke u thirrur në vendimet e bordit aktual për të cilat ankesat janë hudhur jashtë afatit për shqyrtim, ndërsa sa i përket mjeteve të cilat AK ka aluduar se nuk i ka në dispozicion AK obligohet të veproj sipas pikës 2 të dispozitivit të këtij vendimi.

Andaj, PSH vlerëson se pasi jemi në fazën përfundimtare procedurale si dhe duke pasur parasysh rrethanat e cekura si më lartë baza dhe arsyetimi i anulimit nuk përbëjnë aplikim të nenit 62 të LPP-së, apo dispozitave ligjore që lejojnë një AK të anuloj një aktivitet të prokurimit.

Paneli shqyrtues duke zbatuar dispozitën ligjore të nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitë të këtij vendimi.

Kryetare e Panelit shqyrtues
Kimete GASHI



Këshillë Juridike:

Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë që ti drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë me padi, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet;

1x1 AK – KK Prishtinë;

1x1 OE- "Avokatra Istrefi";

1x1 Arhivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së